



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2248 prot.

Pukë, më 10.12.2024

PROJEKT VENDIM

Nr. 04 datë 10.12.2024

PËR

“MBI KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT  
VENDOR TË NDERIT NË BASHKINË PUKË”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, neni 9 neni 54, si dhe ligjin nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e tij, me datë \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_.2024;

VENDOSI:

1. Të ngrihet Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Tituj Vendor të Nderit të Bashkisë Pukë, i përbërë nga:
  - Sokol Gjoni
  - Denisa Meçi
  - Endrit Kraja
  - Rasim Laçi
  - Ylli Hadroj
2. Ky Projekt-Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Endrit Kraja

Kryetari

Rrok Dodaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2246 prot.

Pukë, më 10.12 2024

RELACION

Mbi Projekt-Vendimin “Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”

**Të nderuar këshilltarë!**

Projekt Vendimi që ju paraqesim është një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe i VKM nr. 861 pdatë 16.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, përmes së cilave ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e ngritjes së Komisionit Këshillimor pranë Këshilit të Bashkisë, i cili është organi që jep tituj dhe medalje.

Në nenin 14, pika të ligjit nr. 94/2022, “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë” është e sanksionuar se: “Komisioni këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë janë punonjës nën varësinë e institucionit përgjegjës për dhënien e titullit dhe 2 (dy) anëtarë janë personalitete të jashtme.

Komisioni këshillimor, sipas ligjit, administron propozimet për tituj nderi, i vlerëson ato dhe i paraqet Këshillit të Bashkisë mendimin e tij rast për rast, të shoqëruar me relacionin përkatës.

Vendimet e këtij Komisioni, të cilët merren me shumicë votash janë një ndihmë për vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë, pasi këta janë ekspertë të fushave të ndryshme dhe paraprakisht studiojnë dokumentacionin përkatës të subjekteve që propozojnë dhënien e titujve të nderit dhe medaljeve.

Për rrjedhojë, vlerësojmë se duhet të zgjidhen persona të spikatur, por edhe që janë të angazhuar dhe të përgjegjshëm për detyrate ngarkuara.

Duke paraqitur këtë projekt vendim, sjellim në vëmendje e Këshillit të Bashkisë Pukë faktin se aktualisht në protokollin e Bashkisë janë të administruara shumë kërkesa dhe propozime për dhënie tituj nderi, emërtime rrugësh, sheshesh, propozimesh për shpallje “Dëshmor i Atdheut”, etj të cilat e bëjnë të dmosdoshëm krijimin e Komisionit Këshillimor për të vijuar me procedurat e mëtejshme të vendimmarrjes nga Këshilli i Bashkisë dhe për t’iu dhënë përgjigje përfundimtare të interesuarve.

Më përbërjen e Komisionit kemi propozuar edhe punonjës të Bashkisë, pasi puna e këtij Komisioni miks nuk është vetëm çështje e një mbledhje komisioni siç mund të mendohet, por y komision do të ketë edhe korrespondenca me institucione të tjera.

Rrjedhimisht, ndjekja e të gjithë procedurës së parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kërkon një anagzim në kohë, por edhe një bashkëveprim me administratën e Bashkisë.

Vlerësuar në këtë këndvështrim, përbërja e Komisionit sipas projekt vendimit që paraqesim i përmbush kërkesat e ligjit dhe pritshmëritë e Këshillit të Bashkisë Pukë në funksion të respektimit të plotë të procedurave të parashikuara dhe të vendimmarrjeve, të cilat duhet të jenë sa më të pranueshme edhe nga opionioni public.

Në këto kushte, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e këtij projekt vendimi, i cili do t'i hap rrugë procedurës sa më saktë të akordimit të titujve vendorë të nderit, emërimit të rrugëve, shesheve dhe propozimeve për "Dëshmor i Atdheut" në Bashkinë Pukë.

Duke ju falënderuar!

**Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

**Sokol Gjoni**

